



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
MINISTRI**

Adresa: Bulevardi Bajram Curri", Tiranë, Albania, Tel / Fax: +355 4 3629 37 www.moh.gov.al

Nr. 1688 / Prot.

Tiranë, më 25/5 /2012

U R D H Ë R

Nr. 230 Datë 25.05.2012

PËR

**MËNYRËN E SHKËMBIMIT E TË PËRPUNIMIT TË INFORMACIONIT E TË
DHËNAVE STATISTIKORE TË KËRKUARA NGA AGJENCIA SHTETËRORE
PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TE FËMIJËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 32, të ligjit nr 10347, datë 4.11.2010, " Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës" dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.267, datë 12.4.2012 për "Llojet dhe mënyrën e shkëmbimit e të perpunimit të informacionit e te dhënave statistikore të kërkuara nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës e nga strukturat shtetërore përgjegjese në nivel qendror dhe vendor".

URDHËROJ:

1. Sektori i Statistikave shëndetësore në Drejtorinë e Monitorim Vlerësimit në Ministrinë e Shëndetësisë, ISHP, ASHR/DRSH/DSHP-të në rrethe të raportojnë të dhënat statistikore të mbledhura dhe të përpunuara bazuar në formularët që i bashkëlidhen vendimit Nr.267, datë 12.4.2012 të Këshillit të Ministrave.
2. Sektori i Statistikave shëndetësore në Drejtorinë e Monitorim Vlerësimit në Ministrinë Shëndetësisë dhe ISHP të raportojnë sipas kërkesës dhe periodicitetit të kërkuar nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës.

3. ASHR/DRSH/DSHP-të në rrethe të raportojnë pranë Njesisë për të drejtat e fëmijës në qark sipas periodicitetit të kërkuar në formularët që i bashkëlidhen vendimit.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhëri Drejtoria e Monitorim Vlerësimit në Ministrinë e Shëndetësisë, Instituti i Shëndetit Publik dhe ASHR/DRSH/DSHP-të në rrethe.
5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

PETRIT VASILI

